



Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës  
Nr. 06-29066/25  
Klinë, datë: 28.08.2024

## PROCESVERBAL

Nga dëgjimi i dytë buxhetor për buxhetin e vitit 2025 të Komunës së Klinës, me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshi, Qeskovë, Zajm, Këpuz, Deiq dhe fshatrat e tjera, datë 15.08.2024, ora 18:30, vendi SHFMU "Azem Bejta", Grabanicë.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënavë Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standarde të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 15/09/2024 në emalin [vloratafili@rks-gov.net](mailto:vloratafili@rks-gov.net) ose fizikisht në zyrën e pranimit në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna përfasë përgatitore të dëgjimit përbledhjen na takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i draft buxhetit i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike.

Para të pranishmëve është prezantuar draft buxheti edhe në formatin elektronik në tabelat e mençura.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuar.

Takimi ka nisur në ora 18:30 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtori i Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, Enver Berisha, drejtori i Arsimit, Qemajl Sejdija, drejtori i Inspektoratit, Faruk Smajli, drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Driton Bardheci, këshilltari i kuvendit komunal, Armend Beqiri, anëtarë të grupit punues si dhe banorë të zonave të lartcekura.

**Nga qytetarët morën pjesë 28 persona, prej të cilëve 28 burra dhe 0 gra.**

*Shtoja 1 – Fotografi nga dëgjimi i parë buxhetor për buxhetin e vitit 2025 me banorët e komunës së Klinës, me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Qeskovë, Zajm, Këpuz, Deiq dhe fshatrat e tjera, vendi SHFMU “Azem Bejta”, Grabanicë.*



**Takimi u hap nga moderatori, Mirsad Dakaj, i cili hapi takimin:**

“Përshëndetje të nderuar të pranishëm!

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Financa Publike dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë të hapur në Komuna, sot ne po hapim ciklin e dëgjimeve buxhetore për draft buxhetin e komunës së Klinës për vitin 2025, i cili është një proces shumë i rëndësishëm dhe thelbësor për t'i përcaktuar prioritetet e komunës për vitin e ardhshëm, për t'i pranuar kërkuesat e juaja e të cilat grupi punues për draft buxhet do t'i shqyrtojë dhe analizojë me kujdes.

Në këtë takim jemi këtu bashkë me kryetarin e komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtori i Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, Enver Berisha, drejtorin e Arsimit, Qemajl Sejdija, drejtorin e Kulturës, Rinis dhe Sportit, Driton Bardheci, drejtorin e Inspektoratit, Faruk Smajli, anëtarë të grupit punues si dhe eksperti i angazhuar nga DEMOS-, të cilin e falënderoj për praninë edhe këtu në këtë takim.

Dua të theksoj se komuna e Klinës është vlerësuar nga organizata joqeveritare, si DEMOS-i, e institucione të tjera, si komuna që ka pasur raportin më të mirë në Republikën e Kosovës të cikleve të dëgjimeve buxhetore në vitet e fundit për respektimin në përpikëri të dispozitat ligjore dhe është shembull për komunat e tjera. Me insistim të kryetarit jemi duke u angazhua që rezultatin e mirë që e kemi pasur vitin e kaluar me vazhdu edhe këtë vit dhe me krijua një praktikë të punës transparente dhe llogaridhënëse.

Duke e pasur për bazë këtë, ne si grup punues nuk kemi ndryshu shumë metodën e punës nga viti i kaluar. Në koordinim me kryetarin kemi hartua planin e punës, sikurse vitin e kaluar, ne kemi planifikuar t'i mbajmë 10 dëgjime buxhetore në lokalitete të ndryshme dhe po ashtu jemi të hapur t'i pranojmë kërkuesat e sugjerimet edhe në formë elektronike deri me datën 30 gusht, ndërsa në fund, duke i respektuar edhe kornizën ligjore, draft-buxheti do të miratohet në kuvendin e komunës.

Para se me ia kalu fjalën kryetarit, kisha kërku nga ju që me u nënshkru në listën e pjesëmarrësve, sepse është një nga obligimet që dalin nga Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur.

Po ashtu edhe për kërkuesat e miratuara të qytetarëve, ku këtë vit vetëm në KAB janë të miratuara rrëth 90% të kërkueseve e synojmë që e njëjtë përqindje të jetë edhe në Draft-Buxhet.

Megjithëse ne kemi planifikuar t'i mbajmë takimet në disa lokalitete, kërkuesat nuk duhet të kufizohen.

Të pranishmit u njoftuan nga moderatori se për qëllime të dokumentimit të këtij takimi do hartohet procesverbali dhe komuna do publikoj video dhe fotografi nga ky takim.

Të gjithë të pranishmit dhanë pajtimin për regjistrimin e takimit dhe publikimin e imazheve nga ky takim.

*Shtojca 2 – Fotografi nga dëgjimi i dytë buxhetor gjatë moderimit:*



*Pas përfundimit të fjalimit të moderatorit fjala ju dha kryetarit të komunës.*

**Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:** “Përshëndetje të nderuar të pranishëm, faleminderit shumë për prezencën në këtë takim.

Sot, do të diskutojmë për njërin nga dokumentet më të rëndësishme që harton komuna e Klinës. Do të diskutojmë për atë që ju shqetëson, për atë që dëshironi të përmirësohet, dhe pëmundësitet që duhet të shfrytëzojmë për të ndërtuar një buxhet më të mirë.

Unë së bashku me grupin punues për buxhet po erdhe drejtorët do ti marrim të gjitha ato qe i theksova me lart dhe do ti registrojmë. Andaj kushdo që ka ndonjë kërkesë, vërejtje a sugjerim le ta thotë në këtë takim. Rëndësia e kërkesave për buxhet është e pamohueshme. Çdo kërkesë që paraqitet, çdo projekt i propozuar, dhe çdo iniciativë që diskutohet, përfaqëson nevojat dhe dëshirat e juaja si qytetarë. Edha askush më mirë se sa ju nuk e di se çfarë duhet të investohet.

Ne, do ta kemi me vete në secilin takim drejtorin e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, Enver Berishën e ai do të ndale më shumë të ju njoftoj lidhur me shifrat buxhetore dhe çka përmban

buxheti si dokument, e unë mos me ju marr kohë më shumë do të ndalem tek projektet të cilat janë realizuar dhe ato që do të realizohen deri në fund të këtij viti.

Jemi ende duke zhvilluar punime në projektin apo kontratë e ndërtimit të infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Grabanicë – Bokshiq – Dollovë, e cila ka vlerën afér 170 mijë euro. Kjo kontratë përfshinë;

Po fillojë me fshatin Bokshiq, është duke përfunduar ndriçimi afërsisht dikun një kilometër nëpër disa rrugë të fshatit si dhe rruga për të varrezat. Është drejt përfundimit trotuari me ndriçim modern në Grabanicë, po ashtu afér një kilometër.

Dollovë asfaltimi i disa rrugicave ne gjatësi 1.300 të cilat kanë përfundua 70% te punimeve.

Kanalizim është projekt të cilin po planifikojmë ta fillojimë se shpejti po në këto zona.

I prezantova këto projekte për të siguruar që takimi të jetë sa më produktiv dhe efikas dhe kjo të mundësoj që diskutimi të shtrohet dhe fokusohet në projektet e reja me prioritet dhe të mos përsëriten kërkesat e qytetarëve. Tani po ja kaloj fjalën drejtorit të Financave për draft-buxheti dhe të ju informojë si qëndrojmë me kodet dhe kategoritë buxhetore.

*Pas përfundimit të fjalimit të kryetarit ffala ju dha drejtorit të Financave, Enver Berishës.*

**Drejtori i Financave, Enver Berisha:** “Faleminderit Kryetar, faleminderit edhe gjithë juve të pranishmëve qe jeni këtu sot në këtë dëgjim buxhetor.

Kam kënaqësinë që sot t'ju paraqes buxhetin për vitin e ardhshëm, një dokument që është fryt i analizave të thelluara buxhetore-financiare.

Buxheti i Komunës së Klinës për vitin 2025 është gjithsej, i planifikuar në total prej 16,168,653.00, i cili krahasuar më vitin 2024 është afërsisht 2 milion euro më shumë, i cili ka qenë 14,648,717.00. Nga buxheti i vitit 2025, ajo shumë është e ndarë në këto burime; Granti i përgjithshëm me rreth 6,571,819.00; Granti specifik i arsimit me rreth 5,953,349.00; Granti i shëndetësisë me rreth 1,897,981.00, Të hyrat vetanake me rreth 1,495,504.00; Financimi për shërbimet rezidenciale me rreth 250,000.00, të cilat në jadin në total pra 16,168,653.00.

Ndërsa, buxheti i komunës së Klinës sipas kategorive të shpenzimeve për periudhën 2025 – 2027, është i ndarë në të hyrat totale komunale me rreth 16,168,653.00, siç e thamë edhe më herët, të hyrat vetanake me rreth 1,495,504.00 edhe këtë e theksuan me lart po ashtu, Grantet dhe transferet qeveritare me rreth 14,673,149.00, Pagat dhe mëditjet me rreth 8,800,000.00, Subvencionet më rreth 800,000.00, si dhe ajo që po besojë që juve ju intereson më së shumti e që janë Investimet Kapital, kanë një buxhet prej 4,498,653.00. E për projektet kapitale do të bisedojmë bashkërisht. Siç e shihni në dokumentin fizik të buxhetit të cilin e keni përpara, ne si komunë e kemi hartuar një listë të prioriteteve për vitin 2025, po që të cilën mund të ndryshohet apo plotësohet deri ky buxhet të prezantohet në kuvend për tu miratuar.

Unë, nuk duhet të ju lodh më shumë me shifra, jam këtu për çdo pyetje apo kërkesë qe e keni për deri tani çfarë prezantova, mbesë në dispozicionin tuaj për përgjigje.

Ju falënderoj edhe njëherë!"

**Mirsad Dakaj:** "Faleminderit drejtor,

Atëherë, qytetarë fjala tani është të ju. Ashtu edhe siç e theksova në fillim, për shkak të procesverbalit ju lutem kur të merrni fjalën të thoni emrin, mbiemrin edhe kërkesa juaj ta ketë adresën e specifikuar, mundësish. Urdhëroni ?"

*Pas fjalës së Mirsadir, fjala ju dha banorëve pjesëmarrës.*

**Tafil Baleci, banorë i fshatit Grabanicë:** "Përshëndetje kryetar dhe ju drejtorë së bashku me krejt stafin,

Jemi disa familje qe kemi probleme ku nëpër rrugët e lagjes dhe nëpër oborre të shtëpive pas reshjeve atmosferike po kemi telashe me rrjedhat e ujit. Andaj, si kërkesë deshta me paraqit që komuna apo drejtoria për Shërbime Publike më ndërhy në ç 'bllokimin e kanaleve te rrjedhave ujore.

*Në radhë, foli banori tjetër pjesëmarrës.*

**Sejdi Baleci, banorë i fshatit Grabanicë:** "Përshëndetje kryetar dhe ju drejtorë së bashku me krejt stafin, faleminderit që jeni në bashkësinë lokale në fshatin Grabanicë,

Si kryetar i fshatit Grabanicë, si prioritet i kemi **asfaltimin e rrugicave apo rrugëve lokale, veçanërisht nëpër fshatin Dollovë**, le të shënohet kjo si prioritet i yni. Po në mundësi financiare edhe në lagjen e "Morinëve".

Si kryetar i fshatit, po ashtu njëherësh shprehi shqetësimet e mia dhe të bashkëvendësve për realizimin e projektit të kanalit të uijtjes në Grabanicë, i cili nuk është mjaft funksional.

**Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:** "Faleminderit Sejdi, po e di, që Dollova ka pasur nevojë, pasi qëndrojmë mbrapa më këtë fshat, po presim sivjet që Dollovën ta kompletojmë me asfaltim dhe rregullim të rrugëve lokale.

**Mirsad Dakaj:** "Faleminderit kryetar,

Po z. Sejdi, ne në procesverbal i shënojmë edhe shqetësimet, rekomandimet dhe gjithçka tjetër, jo vetëm kërkesat. Urdhëroni dikush tjetër a dëshiron me marr fjalën?

**Xhevati Thaqi, banorë i fshatit Bokshiq:** "Përshëndetje kryetar dhe ju drejtorë,

Në lagjen "Gryka", kemi probleme të mëdha me energjinë elektrike edhe jemi dikun afër 20 shtëpi me familje dhe kërkesë e kemi **rregullimin e tensionit të rrymës në këtë lagje**.

*Pas fjalës së Xhevat Thaqit, banorit nga fshati Bokshiq, me radhë ju dha fjala banorit tjetër, z. Selim Bardheci nga fshati Grabanicë.*

**Selim Bardheci, banorë i fshatit Grabanicë:** “Përshëndetje kryetar dhe ju drejtorë

Kemi probleme të mëdha me trajtimin e ujerave të zeza, andaj po e paraqes si kërkesë për **kyçje në kanalizim 350 metra përtej lagjes se “Buqaneve”**.

**Mirsad Dakaj:** “Faleminderit Selim,

Dikush tjetër a dëshiron me marr fjalën?

**Idriz Beqiri, banorë i fshatit Grabanicë:** “Përshëndetje kryetar dhe ju drejtorë si dhe gjithë stafin e angazhur, faleminderit që jeni në bashkësinë lokale në fshatin Grabanicë,

Desha të shtojë si kërkesë të përfshihet në buxhet **shtrirja e rrjetit të ndriçimit publik në lagjen e “Morinëve”**. Ju faleminderit!”

*Pas fjalës së Idriz Beqirit, banorë i fshatit Grabanicë, fjalën me radhë e mori Afrim Pasha.*

**Afrim Pasha, banorë i fshatit Këpuz:** “Përshëndetje kryetar dhe ju drejtorë, faleminderit për prezencë,

Siç e thanë edhe një parafolës, për problemet me rrjedhat e ujit edhe ne, disa familje kemi të njëjtat telashe me ujin i cili pas reshjeve atmosferike po kalon nëpër rrugët e lagjes dhe nëpër oborre të shtëpive. Andaj, si kërkesë dua të cekë **ç 'bllokimin e kanaleve te rrjedhave ujore**, të ndahet një fond apo të intervenojë drejtoria përkatëse e cila i ofrojnë këto shërbime. Ju faleminderit edhe njëherë!”

**Mirsad Dakaj:** “Faleminderit Afrim,

“A ka dikush tjetër që dëshiron të merr fjalën?”

Nëse jo, atëherë e shpalli të myllur takimin pas gjithë këtij diskutimi, ne si grup punues bashkë me kryetarin e komunës do të vazhdojmë në takimet e radhës nesër në Volljakë dhe Përçevë. Gjithashtu, ju njoftojë se agjenda e dëgjimeve është mjaft e ngjeshur dhe nëse dikush nga banorët që nuk ka qenë i pranishëm këtu, mund të jetë pjesë e takimeve të tjera siç janë:

Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Volljakë dhe Sferkë, datë 16.08.2024, ora 17:00, vendi SHFM “Dëshmorët”, Volljakë.

Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatit Përçevë, datë 16.08.2024, ora 18:30, SHFMU “Xhafer Gashi”, Përçevë.

Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Shtupel, Kërrnicë, Binxhë, Grabc, Dranashiq (komunitetin joshumicë), datë 19.08.2024, ora 17:00, vendi SHFMU “Avni Zhabota”, Shtupel.

Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Budisalc, Zllakuqan, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë, Rudicë, Videjë, Jagodë, Bërkovë, Krushevë dhe fshatrat e tjera, datë 19.08.2024, ora 19:00, vendi SHFMU “Atë Shtjefën Gjeçovi”, Zllakuqan.

Dëgjim publik me temë “Prioritetet e grave të komunës së Klinës, personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e tjera të margjinalizuara”, datë 21.08.2024, ora 13:00, vendi SHFMU “Ismet Rraci”, Klinë.

Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Gjurgjevik i Madh, Jashanicë, Dush i Vogël, Siqevë, Dobërdol dhe fshatrat e tjera, datë 21.08.2024, ora 18:00, vendi SHFMU “Tre Dëshmorët”, Jashanicë.

Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus bujqit, fermerët, kultivuesit dhe afaristët që operojnë në Klinë, tema e diskutimit “Projektet investive në zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë”, datë 22.08.2024, ora 17:00, vendi Salla e Kuvendit Komunal.

Dëgjim i përgjithshëm me banorët e komunës së Klinë, datë 25.08.2024, ora 17:00, vendi Salla e Kuvendit Komunal.

Për të gjitha këto takime ju kisha lut ta viziton web faqen zyrtare të komunës së Klinës po edhe rrjetin social Facbeook për ma shumë detaje.

Koment, pyetje, sugjerimet e kërkesa e sotme që janë regjistruar në procesverbal, do të trajton në raportin final të dëgjimeve e më pas ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të kuvendit komunal para miratimit të buxhetit. Po që të cilin do ta gjeni të publikuar në web faqen zyrtare e aty mundeni me i pa secili prej juve që ka kontribuar përgjigjen edhe statusin e kërkesave.

Mirëmbetshi!“.

**Takimi u mbyll në ora 19:28.**

*Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësev të ndarë sipas gjinisë.*

Gra	0
Burra	28
Totali	28

Procesmbajtësja,  
Vlora Tafili



A handwritten signature in black ink is positioned above a circular blue official stamp. The stamp has a double-line border and contains the text 'OPŠTINA KLINË' at the top and 'REPUBLIKA KOSOVA' at the bottom. In the center of the stamp is a smaller emblem featuring a building and a tree.